



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2192 prot.

Tiranë, më 02.05.2024

V E N D I M

Nr. 24, datë 02.05.2024

**PËR EMËRIMIN E ZNJ. ERMELINDA NURAJ NËPUNËS CIVIL GJYQËSOR, NË  
KATEGORINË EKZEKUTIVE, SPECIALIST PËR STATISTIKAT GJYQËSORE  
NË SEKTORIN E IT, STATISTIKËS DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
DHE MEDIAN**

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

<b>Ardian DVORANI</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Blerona HASA</b>	<b>Anëtare Zëvendësuese</b>
<b>Leonard STRATAJ</b>	<b>Kancelar</b>

Këshilli i Gjykatës, në mbështetje të nenit 57 të Ligjit nr.98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe të pikës 1 të nenit 13 dhe të nenit 14 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si edhe të vendimit nr. 20, datë 23.04.2024 të Këshillit të Gjykatës,


**V E N D O S I:**

1. Emërimin e Znj, Ermelinda Nuraj nëpunës civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive Specialist për Statistikat Gjyqësore në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.
2. Znj. Ermelinda Nuraj të kryejë dorëzimet e detyrës për pozicionin aktual në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga nxjerrja e këtij vendimi.

3. Ky vendim, së bashku me relacionin shoqërues dhe aktet e tjera të procedurës së plotësimit të këtij pozicioni, i njoftohet kandidates fituese dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, si edhe publikohet në faqen elektronike të Gjykatës.
4. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës dhe Kancelari për zbatimin e këtij vendimi.

**KANCELARI**

**Leonard STRATAJ**



**ANËTARE**

**Blerona HASA**



**ZËVENDËSKRYETARI**

**Ardian DVORANI**

